

## Takimi i Dytë i Dialogut Konsultativ të Mediave

### Përfundimet dhe rekomandimet

Takimi i Dytë i Dialogut Konsultativ të Mediave me temën “Organet rregullatore të mediave – mes teorisë dhe praktikës”, u mbajt më 24 shkurt 2021 dhe mbledhi së bashku 20 veprimtarë nga Serbia dhe Kosova, duke përfshirë gazetarë, redaktorë, juristë me specializim në fushën e mediave, aktivistë të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të organeve rregullatore dhe vetë-rregullatore. Diskutimet adresuan çështjet vijuese:

- *Interesi publik* në sferën e mediave do të duhej të shihet si një tërësi e parakushteve që do t'i vendosnin mediat në shërbim të qytetarëve në mënyrë të palëkundur. Aktualisht, kjo sfidohet nga fakti se strukturat politike në Kosovë dhe në Serbi kanë një rol mbizotërues në përzgjedhjen e anëtarëve të organeve përkatëse rregullatore të mediave elektronike: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në Kosovë dhe Organi Rregullator për Mediat Elektronike (shkurt REM, nga gjuha serbe *Regulatorno telo za elektronske medije*) në Serbi. Procesi për përzgjedhjen e anëtarëve nuk është përshtatur mirë për profesionistët e mediave dhe anëtarët e organeve rregullatore shpesh nuk kanë asnjë lidhje me mediat. Diskutimet theksuan se për të siguruar një shtresë kontrolli që respekton interesin publik, vendimet parlamentare do të duhej të merren në bazë të konsideratës së përgjithshme për mjedisin mediatik dhe jo në bazë të interesave politike të partive dominuese parlamentare. Kjo kërkon një proces të përzgjedhjes me një përqendrim të shtuar në transparencë dhe përfshirje më të madhe të organeve dhe shoqatave profesionale të mediave. Forcimi i rolit të publikut në përzgjedhjen e anëtarëve të organeve rregullatore, në punën e rregullatorëve në tërësi dhe në parandalimin e presionit politik dhe të çdo lloji tjetër mbi organet rregullatore ka rëndësi thelbësore për pavarësinë e tyre. Një angazhim më i madh i gazetarëve profesionistë dhe shoqatave të mediave do të kontribuonte gjithashtu drejt një respekti më të madh për interesin publik.
- Në Kosovë, anëtarët e KPM-së kanë mandat dy, tre ose katërvjeçar që caktohet me short. Kjo shihet si një dobësi që lë hapësirë për presion politik dhe nuk lejon medoemos që anëtarët më të kualifikuar dhe më të pavarur të qëndrojnë në detyrë. Një mandat pesëvjeçar për të gjithë anëtarët do të mundësonte që Komisioni të jetë më rezilient. Në Serbi, diskutimet prekën dobësinë e vetvetishme të një kornize ligjore për funksionimin e REM-it që nuk është e kompletuar dhe nuk është e përputhshme me punën e REM-it. Veçanërisht, Statuti i REM-it ende nuk është harmonizuar me Ligjin për Mediat Elektronike, i cili u adoptua që në vitin 2014. Kjo do të duhej të adresohet në mënyrë të ngutshme.
- Puna e organeve rregullatore është fare pak e dukshme për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë dhe shumica e vendimeve të tyre duket se janë bërë pas dyerve të mbyllura. Transparenca dhe dukshmëria më e madhe lidhur me punën e organeve rregullatore do të zgjonte interesimin e publikut dhe gjithashtu do të rriste besimin e publikut në këto organe. Në të dy vendet, organet rregullatore do të duhej të shqyrtojnë mënyrat për të komunikuar në mënyrë proaktive me publikun e gjerë për të krijuar një kuptim më të mirë lidhur me punën e tyre dhe për të rritur nivelin e besimit ndaj praktikave të tyre të punës.
- Ekziston një mungesë qëndrueshmërie në vendimet dhe sanksionet që organet rregullatore shqiptojnë ndaj ankesave në lidhje me mediat elektronike. Sanksionimi i mediave si një masë

e marrë nga organet rregullatore duhet të standardizohet në mënyrë që të mos shihet si *ad hoc* ose sporadik.

- Financimi i dy organeve rregullatore është i hapur për të qenë qoftë peng i vullnetit të mirë të qeverisë ose i varur nga vullneti i mirë i anëtarëve të saj. Në Kosovë, organi rregullator financohet me grant qeveritar, ndërsa në Serbi puna e tij mbështetet nga tarifa e abonimit/anëtarësisë për mediat elektronike. Financimi i organeve rregullatore do të duhej të jetë i qëndrueshëm dhe i pavarur nga ndikimi politik ose ekonomik.
- Në Serbi, REM-i nuk i monitoroi mediat elektronike në periudhën parazgjedhore në 2020 në përputhje me udhëzimet e Komisionit të Venecias dhe Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut pranë OSBE-së. Kjo është dëshmuar nga heshtja e REM-it për trajtimin e pabarabartë të partive politike. Monitorimi nga një institucion i pavarur vrojtues (*watchdog*) zbuloi se partitë në pushtet trajtoheshin shumë më favorshëm sesa opozita dhe se opozita mezi ishte e dukshme dhe kryesisht u inkuadrua në një kontekst negativ nga të gjitha mediat elektronike që kanë licencë transmetimi në nivel vendi. Organet rregullatore duhet të monitorojnë nga afër mbulimin mediatik të fushatave zgjedhore, të cilat duhet do të duhej të respektojnë standardet e mirënjohura.
- Nuk ka kontroll të qartë dhe efikas mbi organet rregullatore që do të siguronte pavarësinë e tyre të detyrueshme me ligj. Prezantimi i një metode efektive për ofrimin e mbikëqyrjes së punës së rregullatorëve, duke mos komprometuar pavarësinë e tyre, mund të garantojë kontrollin e nevojshëm. Për më tepër, mund të krijohet hapësirë që gjykatat administrative të luajnë një rol në proceset e apelimit ndaj vendimeve të organeve rregullatore.
- Organet rregullatore nuk monitorojnë dhe nuk vlerësojnë mjaftueshëm nëse transmetuesit veprojnë në përputhje me kushtet dhe programet e përcaktuara në licencën e transmetimit për të cilën kishin bërë kërkesë. Një shembull i shëmtuar është ai i një transmetuesi televiziv me licencë të programeve për fëmijë që bart përmbajtje e cila thjesht nuk është e synuar ose e përshtatshme për fëmijët. Si pjesë e veprimtarisë së tyre të rregullt, organet rregullatore do të duhej që të monitorojnë zbatimin e planeve programore dhe të jenë të përgatitur për t'i revokuar licencat nëse ato plane nuk respektohen.

## DIALOGU KONSULTATIV I MEDIAVE 2 - PJESËMARRËSIT

#	EMRI DHE MBIEMRI	POZITA
1	Andjelka Ćup	Kryeredaktore në portalin Gračanica Online: <a href="http://gracanicaonline.com">gracanicaonline.com</a>
2	Ardita Zejnullahu	Drejtoreshë Ekzekutive në Asociacionin e Mediave të Pavarura të Kosovës – AMPEK
3	Besnik Boletini	Gazetar hulumtues
4	Flutura Kusari	Avokate e specializuar në fushën e mediave
5	Gazmend Syla	Drejtori i Informacionit në Televizionin nacional "Klan Kosova"
6	Gordana Novaković	Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit për Shtyp në Serbi
7	Luan Latifi	Drejtor në Komisionin e Pavarur të Mediave të Kosovës
8	Miloš Stojković	Avokat i specializuar në fushën e mediave
9	Nenad Milenkovic	Drejtor në Radiotelevizionin lokal "Puls"
10	Nenad Radosavljevic	Drejtor në Radiotelevizionin lokal "Mir"
11	Serbeze Haxhijaj	Redaktore e lajmeve në Transmetuesin Publik - RTK (Radio Televizioni i Kosovës)
12	Slobodan Cvejić	Ish-anëtar i Këshillit të Trupit Rregullator për Media Elektronike (REM) në Serbi
13	Tamara Skrozza	Gazetare dhe Anëtare e Komisionit të Ankesave për Shtyp në kuadër të Këshillit për Shtyp (organ vetërregullues për shtypin në Serbi)
14	Violeta Hyseni	Anëtare e Komisionit të Pavarur për Media në Kosovë
15	Xhavit Husaj	Drejtor në Radio stacionin lokal "Peja"
16	Željko Bodrožić	Kryetar në Asociacionin e Pavarur të Gazetarëve të Serbisë (NUNS)
17	Zoran Gavrilović	Drejtori Ekzekutiv në BIRODI (Byroja për Hulumtime Sociale)